



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:250755
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05477890
C.nr.483/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, ne çështjen juridike kontestimore të paditësit B.T., nga fshati..., komuna Skenderaj, të cilin e përfaqëson me autorizim V.U. avokat në Vushtrri, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, për kompensim të diferencës së pagës së papaguar për licensim, pas përfundimit të seancës kryesor publike me dt.19.03.2024 jep këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.T., nga fshati..., komuna Skenderaj.
- II. Detyrohet e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur, me seli në Prishtinë, që paditësit, B.T., në emër të kompensimit të diferencës së pagës së papaguar për licensim për periudhën kohore dt.30.07.2018 e deri me dt.31.01.2023 për gjithsej 54 muaj t'ia paguaj shumën prej 3,253.50 euro (tremijë e dyqind e pesëdhjetë e tri euro e pesëdhjetë centë), me kamat ligjore prej 8% nga data e parashtrimit te padisë dt.30.07.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 dite nga dita e pranimit e këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit ligjor.
- III. Obligohet e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur, me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'i paguaj paditësit B.T. shumën prej 280 euro, në afat prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.
- IV. Obligohet paditësi që në emër të taksës gjyqësore – diferencës për padi të paguaj shumën prej 20 euro në afat prej 7 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi, B.T., përmes të autorizuarit në këtë gjykatë ka parashtruar padi me dt.30.07.2021, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur, me seli në Prishtinë, për kompensimit të diferencës së pagës së papaguar për licensim, ku më tutje

ka deklarua se paditësi është në mardhënie pune tek e paditura dhe në bazë të Kontratës Kolektive të dt.18.04.2017 paditësit i takon një e drejtë e tillë.

Nërsa me parashtrësën e dt.24.02.2023 e bëri plotësimin dhe precizimin e padisë sa i përket bazës juridike, ku ka theksuar se tani e tutje baza ligjore e padisë mbështetet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, datë 29.08.2008, si dhe bëri përmirësimin sa i përket emrit të paditësit që gabimisht ishte shkruar Br., e duhet të jetë Ba.

Gjykata me aktvendim për përgjigje në padi me datë 05.01.2024, e ka detyruar të paditurën që të paraqes kundërshtimet e saj lidhur me padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

E padtura me dt.24.01.2024 ka paraqitur përgjigje ne padi duke e kundërshtuar në tersi padinë e paditësit si të pabazuar me pretendimin se, bazuar në Udhëzimin Administrativ të MASHT-it për kualifikimr dhe në bazë të listës së pagave shifet se paditësit i është paguar shuma e kërkaur për kualifikim, më tutje shtoj se padia e paditësit është e mbeshetur në Kontratën Kolektive për Arsim të vitit 2017, e që në asnjë dispozit ligjore të kësaj kontrate nuk përcaktohet veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte dhe se kjo kontratë nuk mund të zbatohet më pasiqë MASHT-i është terhequr nga kjo kontratë me dt.21.11.2022, poashtu bazuar edhe në dispozitat e nenit 341 të LMD-së është përcaktuar se me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit, andaj i propozuan gjykatës që padinë dhe kërkespadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

I autorizuari i paditësit në shqyrtimin kryesor deklaroi se, mbetet pran padisë dhe kërkespadisë, si dhe pran precizimit të padisë, ku më tutje shtoj se në këtë seancë bëjë precizimin e kërkespadisë duke kërkuar që paditësit për periudhen kohore dt.30.07.2018 deri me dt.31.01.2023 për gjithsej 54 muaj t'i kompensohet beneficioni mbi bazën e licensimit, pasi që i njëjti ka të përfunduar studimet Bachelor dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë i takon e drejta e kompensimit shtesë prej 27% të pagës bazë, e cila është në shumën prej prej 459 euro dhe shtesa prej 27% e pagës bazë është 123.93 euro, të cilën e paditura ne mënyrë vullnetare ka paguar vetëm shumën prej 63.68 euro dhe i ka mbetur e papaguar diferenca në shumë prej 60.25 euro, andaj i propozoj gjykatës që ta aprovoj kërkespadinë e paditëses si të bazuar dhe ta obligoj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj diferencën e pagës së papaguar për licensim për 54 muaj shumën prej 3,253.50 euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri ne pagesën definitive.

I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore për hartimin e padisë shumën prej 104 euro, taksen gjyqësore për padi shumen prej 21 euro dhe për një përfaqësim 135 euro, në shume të përgjithshme 260 euro.

Për palën e paditur nuk mori pjesë askush në seancën gjyqësore, nga shkresat e lëndës rezulton se e njëjta është thirrur në mënyrë të rregullt, me parashtrësën së dt.18.03.2024 të dërguar përmes emailit zyrtar e kanë njoftuar gjykatën për mospjesmarrje në seancë dhe kanë deklarua që seanca të mbahet pa pranin e tyre, më tutje shtuan se, qendrojnë pranë përgjegjës në padi duke e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, i propozuan gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata në bazë të nenit 423 par.4 të LPK-së seancën e shqyrtimit kryesor e mbajti pa praninë e të paditurës.

Për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete gjykata administroi si prova: kërkesa drejtuar të paditurës e dt.11.07.2021, kontratë pune nr.133/3 e dt.13.10.2016, lista e pagave EM00024294, licenca e mesmidhensit nr.100003948 e dt.03.12.2012.

Në kuptim të neneve 7 dhe 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata pas vlerësimit të secilës prove veç e veç dhe të gjitha së bashku nga të cilat rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga kërkesa e dt.11.07.2021 u konstatua se paditësi ka kërkuar nga e paditura pagesën për kompensim të stimulimit në të ardhura personale në bazë të licensimit.

Me kontratë pune me nr.133/3 e dt.13.10.2016 konstatohet se paditësi ka themeluar mardhenje pune në kohë të pacaktuar me Agjencinë e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe Arsim për të Rritur si Profesor i Kimisë, i cili ka kualifikimin UP – Fakulteti i FSHMN – Dega e Kimisë.

Në bazë të listës së pagave nga BRK me numër EM00024294 e dt.31.05.2021 konstatohet se paditësi pagën bazë e ka 459 euro.

Nga licenca e mësimdhënësit nr.100003948 lëshuar nga Minitria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë konstatohet se paditësit, B.T., i është lëshuar licencë e mësimdhënësit të karrierës dhe atë nga dt.03.12.2012 deri me dt.03.12.2017.

Gjykata sipas shkresave në lëndë vërtetoi se paditësi për realizimin e drejtave të tij ka shterrur të gjitha mjetet juridike tek e paditura, por e njëjta nuk e ka kryer pagesën për kompensimin e licensimit.

Nuk është kontestues fakti se paditësi është në mardhënie pune tek e paditura, por kontestuese në këtë çështje juridike në mes palëve ndërgjyqëse është mospagimi i diferencës së kualifikimit -licensimit, për të cilën paditësja pretendon se ka të drejtën e kompensimit, ndërsa e paditura e konteston këtë të drejtë me pretendim se një e drejtë e tillë nuk i takon pasi që paditësit i është kompensuar kjo e drejtë për çdo muaj dhe se kërkesa për kompensim është parashkruar.

Gjykata bazuar në nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”, vërtetoi se paditësi ka të drejtën e realizimit të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit në vlerën prej 27% të pagës bazë ashtu siç përcaktohet në Vendimin Nr.01/33 të datës 29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ku në pikën 4.3 të këtij vendimi ku shprehimisht është përcaktuar se “Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %”, kjo bazuar edhe në Mendimin Juridik Nr. GJ.A.214/2023 i datës 05.10.2023 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ku në pikën 1 të këtij Mendimi Juridik është përcaktuar se “Për kërkesat e mësimdhënësve për

kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushtëve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008”.

Baza juridike e padisë është bërë e qartë se e paditura duhet t’i shpërblejë kompensimin sa i përket të drejtës për pagesë shtesë për kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit në vlerën prej 27%, për paditësin për periudhën nga dt.30.07.2018 deri me dt.31.01.2023, ku paditësi është e punësuar tek e paditura dhe pagën bazë e ka 459 euro, andaj në bazë të kualifikimit bachelor i takon kompensimi prej 27% të pagës bazë apo shuma prej 123.93 euro, ku e paditura i ka paguar vetëm pjesërisht shumën prej 63.68 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 60.25 euro për periudhën kohore datë 30.07.2018 deri me datë 31.01.2023, për gjithsej 54 muaj në shumën prej 3,253.50 euro.

Me nenin 8 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve përcaktohet se pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, ndërsa në dispozitat e nenit 245 të po të njëjtit nen është përcaktuar se “Kreditori në marrëdhëniet detyimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”, andaj Gjykata me rastin e vendosjes së çështjes konkrete juridike mori për bazë faktin se e paditura ka qenë e obliguar që vullnetarisht ta përmbush detyrimin ndaj të punësuarve që i plotësojnë kushtet, por këtë obligim nuk e ka përmbushur brenda afatit ligjor.

Gjykata me rastin e vendosjes vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjegje në padi se padia e paditësit është e mbështetur në Kontratën Kolektive për Arsim të vitit 2017 e që në asnjë dispozitë ligjore të kësaj kontrate nuk përcaktohet veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte, mirëpo këto pretendime të tilla i refuzoj si të pabazuara dhe jo relevante bazuar për faktin se baza e padinë së paditësit mbështetet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, poashtu sa i përket pretendimit se e drejta e paditësit për kompensim është parashkruar sipas nenit 341 të LMD-së, këto pretendime të palës së paditur për gjykatën janë të pabazuara për faktin se, sipas dispozitave të nenit 87 të Ligjit të Punës ku është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, e që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim për faktin se, paditësi ka ushtruar padinë në gjykatë me dt.30.07.2021 ku edhe është ndalë periudha e parashkrimit, prandaj ky pretendim i të paditurës dhe pretendimet tjera nuk qenë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatë ligjore në normën prej 8%, është i bazuar në dispozitat e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi në bazë të nenit 452.1 të LPK në të cilat shpenzime janë llogaritur: shuma prej 104 euro për hartim të padisë, taksën gjyqësore për padi shuma prej 20 euro dhe ndryshimin e vlerës së kontestit në shumën prej 20 euro, si dhe për një përfaqësim shumën prej 135 euro, në shumë të përgjithshme prej 280 euro.

Me sa u tha më lartë konform dispozitat të nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.483/2021 me dt.19.03.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.